



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2021

Nr: 167

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT ALEANCA
BASHKIMI POPULLOR - EMIGRACIONI - ORA E SHPRESËS DHE
KONSERVATORËT (ABEOK) PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL
2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm.

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 117, datë 5.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore më datë 8.3.2021.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 132 datë 10.03.2021, vendosi kthimin për korrigjimin e dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).

Brenda afatit ligjor, subjekti zgjedhor koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) ridepozitoi dokumentacionin e korrigjuar.

Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK); Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë i cili vërteton se koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) ka deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputetë rezulton se, përveç kandidatëve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Gjergj Todi Thanasi**, kandidat për deputet, qarku Durrës me numër rendor 4, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 119 datë në 31.07.1990, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka dënuar për dy vepra penal respektivisht me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe një dënim tjetër me 45 ditë burgim, por pa specifikuar të dhënat mbi gjykatën dhe veprën penale.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet **z. Gjergji Todi Thanasi**, në bazë të vendimit nr. 119 datë 31.07.1990 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatohet se vepra penale nuk përfshihet në fushën e ndalimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të verifikimit prima facie të formularit të vetëdeklarimit, në mungesë të përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme Burgjeve, konstatohet se z. Gjergji Todi Thanasi nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Marenglen Ibrush Koçiu**, kandidat për deputet, qarku Gjirokastrë me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin e datës 12.10.2018, Gjykata Administrative, e ka dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 144 i Kodit Rrugor dhe ka marrë dënim me gjobë, i cili është konvertuar me dënimin alternativ “Punë me interes publik” për një periudhë ta pa specifikuar nga subjekti vetëdeklarues.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet **z. Marenglen Ibrush Koçiu**, në bazë të vendimit të datës 12.10.2018 të Gjykatës Administrative, për të cilën është dënua me gjobë, konstatohet se vepra penale nuk përfshihet në fushën e ndalimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të verifikimit prima facie të formularit të vetëdeklarimit, në mungesë të përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme Burgjeve, konstatohet se z. Marenglen Ibrush Koçiu nuk është në kushtet e ndalimit të



kandidimit/moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Kristaq Thanas Papa**, kandidat për deputet, qarku Tiranë me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, **Pikës 5**, “*A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personal, në fuqi ose jo?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është marrë masa shtrënguese “Detyrim për paraqitje” në policinë gjyqësore një herë në muaj për veprën penale “Shpifje” parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, por është revokuar masa e sigurisë nga Gjykata e Apelit Durrës në vitin 2003.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet

z. Kristaq Thanas Papa, për të cilën është marrë masë shtrënguese, konstatohet se nuk përfshihet në fushën e ndalimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të verifikimit prima facie të formularit të vetëdeklarimit, në mungesë të përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme Burgjeve, konstatohet se z. Kristaq Thanas Papa nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ido Muharrem Pashaj**, kandidat për deputet, qarku Fier me numër rendor 03, rezulton se:

Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, pikës “B” të formularit të vetëdeklarimit, Gjenealitete të Mëparshme, të ketë deklaruar se ka ndryshuar emrin nga “Xhevdet” në “Ido”.

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar dënime.

Në bazë të verifikimit prima facie të formularit të vetëdeklarimit, në mungesë të përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme Burgjeve, pritët të bëhen verifikime të mëtejshme nga prokuroria, për shkak se rezulton që në kandidati për deputet z. **Ido Muharrem Pashaj**, të ketë ndryshuar emrin.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2204 prot., datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën 2212 prot. datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë në lidhje me verifikimin e të dhënave të kandidatëve për deputet të Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK)".

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", nga verifikimi *prima facie* i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për deputet, të Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për Zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të Partisë Bindja Demokratike për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", dhe në shkronjën "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar,



V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Nertila	Bari	Shalari	02/04/1987	F	PKKA
2	Vasil	Refat	Mama	25/09/1976	M	P.E.SH
3	Dorjan	Hekuran	Demaj	04/05/1993	M	PKKA
4	Elsa	Bashkim	Voka	15/09/1983	F	PBPPSH
5	Kita	Kostandin	Nova	08/06/1955	M	P.E.SH
6	Andon	Sifi	Qako	25/01/1967	M	PKKA
7	Fatime	Hyqmet	Pepa	24/09/1982	F	PKKA
8	Aleks	Vasil	Bezhani	01/08/1969	M	P.O.SH
9	Marije	Kostandin	Cipi	30/12/1965	M	P.E.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Luan	Kurt	Jakimi	08/05/1967	M	P.E.SH
2	Haziz	Sadik	Peka	27/04/2000	M	PKKA
3	Anila	Ali	Merdani	28/02/1972	F	P.E.SH
4	Kujtim	Islam	Tota	18/05/1957	M	P.E.SH
5	Laim	Sabri	Tota	16/06/1972	M	P.E.SH
6	Dëshire	Musa	Agolli	25/02/1959	F	P.O.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Kujtim	Bajram	Gjuzi	01/04/1959	M	PKKA
2	Ardit	Sali	Gaçi	16/06/1989	M	P.O.SH
3	Anita	Bedri	Dervishi	12/04/1997	F	PKKA
4	Gjergji	Todi	Thanasi	23/04/1966	M	PKKA
5	Islit	Ismail	Malo	23/04/1991	M	P.O.SH
6	Fabiola	Bektash	Mama	25/09/1979	F	P.E.SH
7	Denis	Ilir	Biçaku	23/10/2001	M	PKKA
8	Kadri	Xhemal	Muka	13/05/1956	M	PKKA
9	Mimoza	Ali	Elezi	08/06/1973	F	P.E.SH
10	Agron	Bashkim	Shabani	06/04/1980	M	PKKA
11	Ervis	Harun	Beu	24/06/1981	M	PKKA
12	Alma	Basri	Muda	14/08/1978	F	PKKA
13	Valdet	Hysen	Deralla	28/02/1944	F	PKKA
14	Adivie	Halit	Vraniçi	11/01/1990	F	PKKA
15	Kujtim	Telha	Mema	18/08/1964	M	P.E.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Dylaver	Hyqmet	Pepa	10/07/1996	M	PKKA
2	Enkeleda	Veli	Latifi	13/12/1983	F	P.E.SH
3	Kastriot	Ibrahim	Hysaj	26/02/1956	M	PKKA
4	Shkelzen	Haxhi	Kreci	06/06/1973	M	P.E.SH
5	Adela	Niko	Dine	16/04/1982	F	P.E.SH
6	Mithat	Dalip	Pisha	04/06/1965	M	P.E.SH
7	Klevis	Agron	Çapia	26/06/1997	M	PKKA
8	Lindita	Naun	Bezhani	12/09/1971	F	P.E.SH
9	Ibrahim	Kamber	Shabani	15/03/1999	M	P.E.SH
10	Ardjan	Kadri	Gjuzi	20/04/1973	M	PKKA
11	Marjana	Ramazan	Dollani	25/07/1971	F	P.E.SH
12	Alban	Shkelqim	Cani	22/02/1992	M	P.E.SH
13	Elton	Osman	Kullolli	29/05/1985	M	P.E.SH
14	Afërdita	Cac	Cani	05/01/1966	F	P.E.SH
15	Armandi	Tasi	Narta	03/05/1987	M	P.E.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Marinela	Nasi	Petro	24/09/1995	F	PKKA
2	Agim	Abedin	Zyka	23/08/1953	M	PKKA
3	Ido	Muharrem	Pashaj	04/10/1958	M	PKKA
4	Adeliona	Qemal	Llapushi	12/04/1998	F	P.E.SH
5	Agim	Zalo	Tomorri	15/04/1966	M	PBPPSH
6	Festim	Hysen	Zanaj	05/05/1982	M	PKKA
7	Shqipe	Islam	Narta	20/02/1985	F	P.E.SH
8	Marjo	Tajar	Çela	01/06/1992	M	P.E.SH
9	Iliri	Hjeni	Çullhaj	24/11/1968	M	PKKA
10	Bleona	Barjam	Qori	14/03/2001	F	P.E.SH
11	Lirim	Muhamet	Pole	02/06/1965	M	P.E.SH
12	Niko	THoma	Suli	04/07/1966	M	P.E.SH
13	Nafie	Avdyl	Qerimi	03/09/1990	F	PKKA
14	Roland	Hektor	Llato	21/08/1959	M	P.E.SH
15	Vladimir	Demo	Ruçi	21/10/1956	M	P.E.SH
16	Luiza	Shaqir	Miraka	24/05/1975	F	P.O.SH
17	Bardhyl	Hysen	Harizi	23/09/1964	M	P.E.SH
18	Ylli	Zylfer	Zagradi	15/05/1971	M	P.E.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **18**Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Mariglen	Ibrush	Kociu	27/04/1968	M	PKKA
2	Odhisea	Pilo	Gremo	16/05/1964	M	P.E.SH
3	Rudjana	Polion	Shkrepa	10/01/1995	F	P.E.SH
4	Viktor	Vasil	Bezhani	29/03/1973	M	P.E.SH
5	Bujar	Adem	Reka	04/01/1957	M	P.O.SH
6	Anula	Kanan	Mama	06/06/1971	F	PKKA

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **6**



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Erald	Veli	Latifi	18/05/1993	M	P.E.SH
2	Spiro	Vasil	Bezhani	18/07/1965	M	P.E.SH
3	Ines	Lefter	Ranxha	13/04/1997	F	P.E.SH
4	Rozher	Serafin	Prifti	17/11/1959	M	PKKA
5	Andreas	Miftar	Metushi	06/04/1975	M	P.E.SH
6	Tesial	Drin	Ibrahimi	27/06/1974	F	P.O.SH
7	Arjan	Dashmir	Avdolli	30/09/1980	M	PKKA
8	Anduen	Faslli	Hymeri	19/06/1988	M	P.E.SH
9	Alma	Ali	Ramku	20/05/1955	F	PKKA
10	Spiro	Rafail	Josifi	12/07/1964	M	P.E.SH
11	Landi	Veli	Latifi	26/02/1986	M	PKKA
12	Nadire	Avdyl	Zemblaku	19/05/1981	F	P.O.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Akil	Abedin	Sokolaj	25/11/1993	M	PBPPSH
2	Sanie	Isuf	Hajdarmetaj	25/10/1973	F	PKKA
3	Jetmira	Rexhem	Shabani	28/10/1984	F	PKKA

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Gjergji	Dhosi	Theodhosi	27/02/1940	M	PKKA
2	Valentin	Gjovalin	Marku	01/08/1983	M	PKKA
3	Sarina	Rrok	Zaja	19/04/1994	F	PKKA
4	Artur	Spiro	Merdani	11/06/1969	M	P.E.SH
5	Artur	Gjovalin	Ndreka	19/08/1985	M	PKKA
6	Fatjona	Gjin	Zaja	27/03/1995	F	P.O.SH
7	Pali	Jani	Panxhi	08/03/1960	M	P.E.SH
8	Valdete	Isuf	Hajdarmetaj	01/01/1976	F	P.O.SH
9	Ada	Shpetim	Gjeloshaj	22/07/1997	F	PKKA

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Zef	Gjon	Shtjefni	08/11/1964	M	P.O.SH
2	Shtjefen	Zef	Staku	07/01/1960	M	PKKA
3	Silvana	Ndue	Bushati	16/10/1987	F	PKKA
4	Merita	Idriz	Preza	25/02/1973	F	P.O.SH
5	Hilmi	Rame	Plava	25/05/1947	M	PBPPSH
6	Anxhelo	Anastas	Nika	03/11/1994	M	P.E.SH
7	Esmeralda	Sander	Ndreca	07/07/1993	F	PKKA
8	Altin	Losh	Gjeloshaj	25/12/1991	M	PKKA
9	Jurgen	Edmond	Fregjaj	13/07/2000	M	P.O.SH
10	Bardhe	Ndoke	Lisi	30/06/1983	F	PKKA
11	Sabina	Shpetim	Zejneli	03/10/1998	F	P.O.SH
12	Bernard	Zef	Lejthia	07/02/1963	M	PKKA

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Kostaq	Thanas	Papa	25/08/1963	M	P.E.SH
2	Selami	Ahmet	Jenishehri	14/02/1964	M	PBPPSH
3	Pajtesa	Idris	Bisha	02/03/1980	F	PKKA
4	Enriko	Thoma	Ceko	29/09/1965	M	PKKA
5	Shpetim	Bakush	Kodhelaj	15/09/1976	M	PKKA
6	Erinda	Milaim	Nela	29/04/1984	F	PKKA
7	Olsi	Nafiz	Jazxhiu	01/01/1977	M	PKKA
8	Hyqmet	Sul	Hamati	10/07/1969	M	PKKA
9	Violeta	Xhemal	Hoxha	23/01/1984	F	PKKA
10	Stavraq	Sokrat	Trako	06/09/1951	M	PKKA
11	Vladimir	Pandeli	Nikolla	14/05/1959	M	P.E.SH
12	Eralda	Dylber	Murati	22/05/1983	F	P.E.SH
13	Maksim	Xhavit	Ferra	13/07/1956	M	PKKA
14	Klodjan	Luman	Troplini	04/06/1982	M	PKKA
15	Florinda	Ivzi	Mata	23/01/1980	F	PBPPSH
16	Gino	Arben	Zefi	10/11/1996	M	P.O.SH
17	Leonard	Kujtim	Mema	24/09/1992	M	P.E.SH
18	Insida	Kujtim	Kullolli	03/11/1989	F	P.E.SH
19	Algert	Bardhyl	Skenderi	16/07/1986	M	PKKA
20	Ilir	Qamil	Alushi	14/02/1964	M	PKKA
21	Arba	Arben	Sinakoli	03/08/1996	F	P.O.SH
22	Artan	Qemal	Gjinali	24/06/1967	M	PKKA
23	Arjan	Jemin	Hoxha	27/07/1970	M	PKKA
24	Anisa	Pajtim	Saraçi	11/05/1997	F	P.O.SH
25	Beqir	Ruzhdi	Agolli	26/03/1957	M	P.E.SH
26	Perparim	Hamdi	Memia	12/07/1968	M	PBPPSH
27	Ira	Safet	Kurti	08/02/1964	F	PBPPSH
28	Euxhes	Pellumb	Fetahu	15/06/1995	M	P.E.SH
29	Ergys	Agime	Musliu	23/09/1993	M	P.O.SH
30	Jonida	Agim	Gjoka	02/04/1970	F	P.O.SH
31	Ahmet	Fadil	Çaveli	23/06/1967	M	P.E.SH
32	Xhejni	Lirim	Pole	29/09/1994	F	P.E.SH
33	Mimoza	Ruhi	Shosha	06/06/1961	F	P.E.SH
34	Marsel	Gjovalin	Zaja	31/08/1994	M	PKKA
35	Florian	Zenel	Xeka	27/12/1995	M	PKKA



Lista shumemërore

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
36	Alma	Hamdi	Harizi	05/11/1975	F	P.E.SH

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 36Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët
Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Gezim	Njazi	Boçari	25/03/1949	M	P.E.SH
2	Albriç	Baki	Deraj	30/04/2000	M	PKKA
3	Lejka	Korab	Bonjakaj	02/06/1990	F	PKKA
4	Shpetim	Ruhi	Zinxhiria	23/06/1955	M	P.E.SH
5	Arqile	Stavri	Janku	25/09/1963	F	P.E.SH
6	Elsaveta	Filip	Beqiraj	18/01/1956	F	P.E.SH
7	Tasim	Emin	Mehmeti	10/05/1956	M	P.E.SH
8	Dhionis	Nikolla	Kënini	26/05/1973	M	P.E.SH
9	Joana	Çerciz	Karajani	23/06/1968	F	P.E.SH
10	Hristo	Filip	Beqiraj	25/05/1949	M	P.E.SH
11	Jetnor	Sali	Haruni	07/05/1975	M	P.E.SH
12	Drita	Megjit	Duka	01/03/1974	F	PKKA

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë